

Ekskluzive

Ekskluzive | Këta janë të dyshuarit për tentim-vrasjen në sheshin “Isa Boletini” në Mitrovicë – të shtëna nga dy anët, të dy në arrati



Sinjali.com

10 Gusht 2026 09:31



Sinjali ka mësuar identitetin e dy personave që po kërkohen lidhur me incidentin e rëndë me të shtëna që ndodhi të dielën në sheshin “Isa Boletini” në Mitrovicë, rast ky që tashmë po hetohet si “Vrasje në tentativë”.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se të dyshuarit janë **Endri Cakiqi** rreth 18 vjeçar dhe **Albi Cakiqi** rreth 24 vjeçar, të cilët nuk janë lokalizuar ende nga Policia.

Ngjarja ndodhi më 9 gusht, rreth orës 15:30, kur u raportuan të shtëna me a*më brenda një ndërtese banimi.

Nga hetimet fillestare dyshohet se nga banesa ku jetojnë të dyshuarit është shtënë në drejtim të disa personave që ndodheshin në korridor. Në vendin e ngjarjes janë gjetur gëzhoja të kalibrave të ndryshëm, çka ka ngritur dyshimet se është shtënë nga dy palë.

Nga të shtënat janë dëmtuar dy dyer të banesave, ndërsa hetuesit kanë sekuestruar gëzhojat dhe predhat e gjetura në vendin e ngjarjes.

Motivi i përplasjes ende nuk dihet.

Me urdhër të Prokurorit të Shtetit, rasti është iniciuar si “Vrasje në tentativë”, ndërsa hetimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes po vazhdojnë.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera